



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi European



QENDRA KOMBËTARE BURIMORE  
e SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



PARTNERËT SHQIPËRI  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

# AKADEMIA E MENAXHIMIT TË AVANCUAR FINANCIAR PËR OJF-TË

Një program profesional i certifikuar në Shqipëri që i kushtohet posaçërisht nevojave të menaxherëve dhe specialistëve të financës në sektorin jofitimprurës.

>>



# Përmbajtja



- 04 Rreth Akademisë
- 05 Objektivi i Programit
- 06 Pse një Akademi e Menaxhimit Financiar për OJF-të?
- 07 Çfarë ofron Akademia?
- 08 Metodologjia
- 10 Përmbajtja e Programit
- 12 Kalendari i Akademisë 2025
- 13 Organizatorët e Akademisë
- 14 Kontakt


---

# Akademia e Menaxhimit të Avancuar Financiar për OJF-të

**Transparencë**



**Efikasitet**



**Llogaridhënie**



**Besueshmëri**



**Qëndrueshmëri**



# Rreth Akademisë

## FUQIZIM PËRMES EDUKIMIT FINANCIAR

**Akademia e Menaxhimit të Avancuar Financiar për OJF-të** është një program profesional dhe i certifikuar në Shqipëri, i krijuar posaçërisht për të përmbushur nevojat e menaxherëve dhe specialistëve të financës në sektorin jofitimprurës.

Ajo është ndërtuar për t'u ofruar organizatave një qasje të strukturuar për përmirësimin e praktikave financiare dhe rritjen e kapaciteteve të tyre për të përballuar një realitet gjithnjë e më sfidues.

Programi kombinon **përvojë praktike dhe njohuri të avancuara** për të ndihmuar pjesëmarrësit të përmbushin kërkesat ligjore dhe fiskale, të shmangin penalitetet dhe të menaxhojnë fondet në mënyrë efikase e të përgjegjshme. Ai synon gjithashtu të mbështesë organizatat në ndërtimin e strategjive për diversifikimin e burimeve financiare, sigurimin e bashkëfinancimeve dhe rritjen e besueshmërisë në raport me donatorët dhe palët e interesuara.

Akademia **kontribuon në ndërtimin e një kulture organizative** të bazuar në transparencë, llogaridhënie dhe planifikim të qëndrueshëm, duke fuqizuar OJF-të të luajnë një rol më të fortë në zhvillimin demokratik dhe shoqëror.

Ajo **nxit përvetësimin e praktikave bashkëkohore të menaxhimit financiar** dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, ndihmon në menaxhimin e rreziqeve dhe përputhshmërinë me ligjin, si dhe mbështet ngritjen e strukturave të brendshme që garantojnë stabilitet dhe besueshmëri afatgjatë.

*Programi është i certifikuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kualifikimin profesional, dhe do të zhvillohet në një periudhë gjashtëmuajore (maj - nëntor 2025).*



# Objektivi i Programit

Akademia synon të ofrojë një zhvillim të thelluar profesional për menaxherët dhe specialistët e financës në sektorin jofitimprurës, përmes përvetësimit të njohurive të avancuara dhe praktikave të standardizuara në fushën e menaxhimit financiar.

Qëllimi është t'i ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë dhe të zbatojnë me efektivitet kërkesat ligjore dhe fiskale, të përforcojnë strukturat e brendshme financiare dhe të zhvillojnë kapacitete për të siguruar qëndrueshmëri financiare dhe besueshmëri organizative.

Ky program është një investim praktik për ata që duan të kuptojnë më mirë sfidat dhe mundësitë që sjell mjedisi financiar dhe ligjor, të përshtatin praktikat e tyre me kërkesat në ndryshim, të forcojnë funksionimin e brendshëm të organizatës dhe të rrisin besueshmërinë ndaj donatorëve dhe publikut.



---

# Pse një Akademi e Menaxhimit Financiar për OJF-të?

Shoqëria civile është një aktor thelbësor në zhvillimin demokratik, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e interesit publik. Në kontekstin aktual të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ky rol është gjithnjë e më i vlerësuar si pjesë e një sistemi demokratik funksional. Por që të jetë vërtet një faktor ndryshimi, sektori duhet **të jetë i qëndrueshëm, financiarisht i fortë dhe i aftë për të përmbushur standarde të larta të transparencës dhe llogaridhënies.**

Pavarësisht rritjes numerike të organizatave – me rreth 270 OJF të reja të regjistruara çdo vit – sfidat e menaxhimit financiar janë të vazhdueshme dhe thellohen edhe më shumë nga ndryshimet e shpeshta në kuadrin ligjor dhe fiskal. Masa të tilla si fiskalizimi, regjistrimi i pronarëve përfitues dhe detyrime të reja për pajtueshmëri me ligjet kundër pastrimit të parave dhe luftës kundër terrorizmit, kanë krijuar një realitet të ri kompleks, të cilin shumë organizata e përballojnë me vështirësi. Këto ndryshime jo vetëm që kërkojnë njohuri të përditësuara, por shpesh edhe përballje **me kosto financiare dhe administrative të larta.**

Në të njëjtën kohë, çështje si rimbursimi i TVSH-së për grantet dhe paqartësitë në zbatimin e përjashtimit tatimor kanë krijuar pasiguri të vazhdueshme në planifikimin dhe administrimin e fondeve. Sipas raportit të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (2024), **mjedisi operues për OJF-të mbetet i paqëndrueshëm dhe kërkon ndërhyrje sistematike** për të garantuar funksionimin efektiv të tyre.

Pikërisht në këtë kontekst, ndërtimi i kapaciteteve financiare përbën një domosdoshmëri strategjike për sektorin dhe një prioritet real për forcimin e qëndrueshmërisë dhe besueshmërisë së OJF-ve. Akademia e Menaxhimit të Avancuar Financiar për OJF-të është ndërtuar si përgjigje ndaj kësaj nevojë. Ajo nuk është vetëm një mundësi për ngritje kapacitetesh — është një investim strategjik për **të ardhmen organizative**, për të forcuar rolin e sektorit në një mjedis gjithnjë e më kërkuar dhe dinamik.

Përmes përmbajtjes së saj praktike, përqendrimit në sfida reale dhe ofrimit të zgjidhjeve të aplikueshme, Akademia ofron **një hap cilësor përpara për organizatat që duan të jenë të qëndrueshme, të besueshme dhe të përgatitura për të vepruar me ndikim në një kontekst sfidues financiar dhe institucional.**

# Çfarë ofron Akademia:



Njohuri të thella mbi kuadrin ligjor fiskal dhe qeverisës të sektorit jofitimprurës, që do t'ju ndihmojnë të menaxhoni me efikasitet kërkesat ligjore dhe rregullatore të lidhura me financat e organizatës.



Aftësi për të krijuar dhe zbatuar praktika të qarta dhe transparente financiare, duke përfshirë sistemet e kontrollit të brendshëm dhe rritur llogaridhënien dhe qëndrueshmërinë e organizatës.



Kompetenca në menaxhimin e riskut, prokurimeve dhe granteve, duke garantuar pajtueshmëri me rregullat dhe përdorim të përgjegjshëm të burimeve financiare.



Aftësi për të diversifikuar të ardhurat, përmes strategjive financiare afatgjata të përshtatura me misionin dhe objektivat e organizatës.



Njohuri mbi matjen dhe komunikimin e ndikimit social, përmes përdorimit të qasjeve dhe mjeteve praktike që ndihmojnë në vlerësimin e rezultateve të arritura, monitorimin e zbatimit të ndërhyrjeve, dhe forcimin e llogaridhënies ndaj donatorëve, duke treguar vlerën reale të punës së organizatës në komunitet.



Përdorim të mjeteve digjitale dhe teknologjive financiare, për të përmirësuar efikasitetin, transparencën dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna.



Qasje në një rrjet profesionistësh financiarë të sektorit jofitimprurës, duke ju ofruar mundësi rrjetëzimi dhe shkëmbimi përvojash mbi çështje konkrete si sfidat e përputhshmërisë fiskale, raportimi financiar, sigurimi i fondeve dhe transformimi digjital i menaxhimit financiar.



# Qasja dhe Metodologjia

*Çfarë e bën Akademinë një eksperiencë të vlefshme?*



## **QASJE E ORIENTUAR DREJT SË ARDHMES**

Në Akademi do të gjeni një program të ndërtuar posaçërisht për nevojat aktuale të menaxhimit financiar në sektorin jofitimprurës.

Përmbajtja i përgjigjet dinamikave të reja të financimit, kërkesave për transparencë dhe rolit në rritje të teknologjisë digjitale, duke ju ndihmuar të zhvilloni strategji praktike dhe të qëndrueshme për organizatën tuaj, si dhe duke nxitur bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave me aktorë të tjerë të sektorit.

## **MJEDIS MËSIMOR GJITHËPËRFSHIRËS DHE BASHKËPUNUES**

Akademia është ndërtuar mbi përvojën e gjatë të Partnerëve Shqipëri në zhvillimin e kapaciteteve të OJF-ve dhe ofron një mjedis që nxit pjesëmarrjen aktive, shkëmbimin e ideve dhe ndërtimin e rrjeteve të qëndrueshme profesionale. Përmes një përzgjedhjeje të kujdesshme të lektorëve, pjesëmarrësit ekspozohen ndaj ekspertizës së lartë në fushën e financave, ndërsa rrjetëzimi me profesionistë të tjerë të sektorit krijon mundësi të reja për bashkëpunim dhe mbështetje në përballimin e sfidave të përbashkëta.

## **KOMBINIM I TEORISË ME PRAKTIKA KONKRETE**

Programi është i ndërtuar mbi një metodologji që ndërthur njohuritë teorike me përvojat konkrete të terrenit. Leksionet zhvillohen nga ekspertë me eksperiencë të drejtpërdrejtë në menaxhimin financiar të OJF-ve, të cilët do të ndajnë shembuj konkretë të sfidave dhe rasteve të suksesit. Pjesëmarrësit angazhohen në diskutime, ushtrime praktike dhe mentorim të personalizuar, me qëllim zbatimin e menjëhershëm të njohurive në punën e tyre të përditshme.

# Kush mund të aplikojë?

Akademia është e hapur për menaxherë dhe specialistë të financës të organizatave të shoqërisë civile, që janë të angazhuar me menaxhimin e fondeve, raportimin financiar dhe/ose zhvillimin e praktikave të qëndrueshme financiare brenda organizatës.

Programi synon të përfshijë organizata nga fusha të ndryshme të shoqërisë civile dhe nga të gjitha rajonet e Shqipërisë, duke garantuar një përfaqësim të balancuar si tematik ashtu edhe gjeografik.



25 pjesëmarrës do të përzgjidhen për Akademinë e Menaxhimit të Avancuar Financiar për OJF-të, 2025.



Të gjithë të interesuarit janë të ftuar të dërgojnë [formularin e aplikimit](#) dhe CV deri më 4 maj 2025 në adresën e email: [info@resourcecentre.al](mailto:info@resourcecentre.al).

Kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen brenda datës 9 maj 2025. **Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen.**



**Shënim: POLITIKA JODISKRIMINUESE E PRANIMEVE NE AKADEMI**

Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve Partnerët Shqipëri do të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit mbi baza gjinore, fetare, etnie apo orientimi seksual.



# Përmbajtja e Programit

1

## Bazat e Sektorit Jofitimprurës: Kuptimi i kuadrit ligjor dhe qeverisës

- Ky modul ofron njohuri thelbësore mbi kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e OJF-ve në Shqipëri, përfshirë procesin e regjistrimit, detyrimet ligjore dhe standardet e qeverisjes së mirë.
- Pjesëmarrësit do të kuptojnë rolin e institucioneve mbikëqyrëse, funksionimin e bordeve dhe rëndësinë e transparencës dhe etikës në drejtimin e organizatave.
- Një vëmendje e veçantë i kushtohet Legjislacionit Fiskal për OJF-të, duke shqyrtuar aktivitetet ekonomike dhe joekonomike, regjimet tatimore, detyrimet dhe procedurat e deklarimeve, duke shmangur penalitetet dhe risqet e mospërputhjes ligjore.

3

## Prokurimi, Kontrolli Financiar dhe Menaxhimi i Rrezikut

- Në këtë modul, pjesëmarrësit do të marrin njohuri për proceset e prokurimit dhe do të aftësohen për zbatimin e mekanizmave efektivë të kontrollit të brendshëm financiar.
- Pjesëmarrësit do të mësojnë të identifikojnë dhe menaxhojnë risqet financiare dhe ligjore, duke siguruar përdorimin efikas dhe të përgjegjshëm të fondeve, me qëllim forcimin e integritetit dhe qëndrueshmërisë së organizatës.

2

## Qeverisja Financiare: Krijimi i praktikave të qarta dhe transparente financiare brenda organizatës

- Moduli trajton praktikatat më të mira të menaxhimit financiar dhe transparencës financiare.
- Pjesëmarrësit do të marrin njohuri për menaxhimin financiar dhe parimet e tij, hartimin dhe analizën e pasqyrave financiare, buxhetimin efektiv, raportimin financiar dhe kontabilitetin, duke rritur qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e organizatës.
- Prezantimi dhe diskutimi i këtyre çështjeve i ndihmon përfaqësuesit e organizatave të menaxhojnë më mirë financat e organizatave që ata përfaqësojnë, si dhe të mendojnë në mënyrë kritike për krijimin e qëndrueshmërisë financiare.

4

## Menaxhimi Efektiv i Granteve: Pajtueshmëria dhe raportimi për iniciativat të financuar nga grantet

- Ky modul trajton administrimin financiar të granteve nga donatorët, me fokus në detyrimet e pajtueshmërisë dhe raportimit financiar e narrativ.
- Pjesëmarrësit do të njihen me praktika konkrete që garantojnë transparencën dhe rrisin besueshmërinë ndaj donatorëve, duke forcuar kështu marrëdhëniet afatgjata dhe potencialin për financime të mëtejshme.



# Përmbajtja e Programit

5

## Planifikimi Strategjik Financiar dhe Monitorimi

- Moduli trajton planifikimin strategjik të financave organizative, duke aftësuar pjesëmarrësit të hartojnë dhe monitorojnë buxhete në përputhje me misionin dhe objektivat e organizatës.
- Moduli synon të forcojë kapacitetet për menaxhimin e qëndrueshëm financiar jo vetëm në nivel projekti, por edhe në nivel të buxhetit të përgjithshëm organizativ, duke nxitur një qasje gjithëpërfshirëse që ruan pamjen strategjike dhe balancën ndërmjet burimeve dhe prioritetëve të organizatës.
- Pjesëmarrësit do të fitojnë aftësi për të përshtatur vazhdimisht buxhetet me kushtet dhe sfidat e ndryshueshme të financimit, duke rritur qëndrueshmërinë financiare dhe efektivitetin operacional.

6

## Diversifikimi i të Ardhurave

- Në këtë modul, pjesëmarrësit do të aftësohen për të zhvilluar strategji efektive për diversifikimin e financimit të organizatës.
- Pjesëmarrësit do të njihen me modele praktike të gjenerimit të të ardhurave alternative, si dhe identifikimin e mundësive të reja të financimit dhe donatorëve të ndryshëm.
- Moduli ndihmon pjesëmarrësit të sigurojnë një bazë të qëndrueshme financiare dhe të ulin varësinë nga burimet tradicionale të financimit, duke krijuar fleksibilitet dhe qëndrueshmëri afatgjatë në përbushjen e misionit të organizatës.

7

## Komunikimi efektiv i ndikimit social të organizatës

- Në këtë modul, pjesëmarrësit do të marrin njohuri mbi metodologjitë praktike të matjes dhe komunikimit të ndikimit social të projekteve të tyre, me qëllim justifikimin e financimeve dhe ndërhyrjeve.
- Pjesëmarrësit do të aftësohen për të përdorur mjete praktike për raportim efektiv tek donatorët dhe për forcimin e besueshmërisë së organizatës në komunitet.

8

## Mjetet për Menaxhimin Financiar

- Ky modul trajton përdorimin e mjeteve digjitale dhe sistemeve të automatizuara për menaxhimin financiar.
- Pjesëmarrësit do të njihen me aplikime praktike të software-eve financiarë dhe analizës së të dhënave financiare, duke aftësuar organizatat të marrin vendime të sakta dhe transparente, të reduktojnë kostot operative dhe të rrisin efikasitetin e përgjithshëm financiar.



# Kalendari i Akademisë

| Data            | Modulet                                                                                                                                         |
|-----------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 20 maj 2025     | Bazat e Sektorit Jofitimprurës: Kuptimi i kuadrit ligjor dhe qeverisës.                                                                         |
| 10 qershor 2025 | Qeverisja Financiare: Krijimi i praktikave të qarta dhe transparente financiare brenda organizatës.                                             |
| 1 korrik 2025   | Prokurimi, Kontrolli Financiar dhe Menaxhimi i Rrezikut: Sigurimi i menaxhimit të duhur financiar dhe zvogëlimi i rreziqeve.                    |
| 22 korrik 2025  | Menaxhimi Efektiv i Granteve: Pajtueshmëria dhe raportimi për iniciativat të financuar nga grantet.                                             |
| 9 shtator 2025  | Diversifikimi i Të Ardhurave: Qëndrueshmëria organizative përmes nismave të suksesshme të gjenerimit të të ardhurave.                           |
| 30 shtator 2025 | Planifikimi Strategjik Financiar: Buxhetimi për një ndikim në misionin e organizatës dhe monitorimi i buxhetit efektiv.                         |
| 21 tetor 2025   | Metodologjitë e Matjes së Ndikimit: Komunikimi efektiv i ndikimit social të organizatës.                                                        |
| 11 nëntor 2025  | Mjetet e Menaxhimit Financiar: Përdorimi i software-eve, mjeteve të automatizimit dhe të të dhënave analitike për qëndrueshmërinë organizative. |

---

# Organizatorët e Akademisë



Akademia e Menaxhimit të Avancuar Financiar për OJF-të është një nismë e zhvilluar nga **Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim**, një organizatë lider në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri dhe rajon. Me një përvojë mbi 20-vjeçare, Partnerët Shqipëri kontribuon në rritjen e kapaciteteve të organizatave jofitimprurëse, fuqizimin e qytetarisë aktive dhe nxitjen e një mjedisi mundësues për veprimtarinë e pavarur dhe të qëndrueshme të shoqërisë civile.

Programi zbatohet nga **Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile** në Shqipëri - një platformë informimi dhe shërbimesh për sektorin, nismë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim - në partneritet me **Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)** dhe **Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA)**, me mbështetjen e **Bashkimit Evropian**.

Përmes këtij programi, organizatorët synojnë të ofrojnë jo vetëm një mundësi të vlefshme për zhvillim profesional, por edhe të kontribuojnë konkretisht në ndërtimin e një sektori civil më të qëndrueshëm, të përgatitur dhe me ndikim të vërtetë në zhvillimet demokratike të vendit.

---

# Kontakt

Për informacione të mëtejshme mbi Akademinë dhe procesin e aplikimit, ju mund të na kontaktoni në:

**Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim**

Email: [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org)

Website: [www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)

**Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile**

Email: [info@resourcecentre.al](mailto:info@resourcecentre.al)

Website: [www.resourcecentre.al](http://www.resourcecentre.al)

**Rruga e Elbasanit, Godina Park Gate, Kati I 10-të,  
Ap. 71 / 73, PO BOX 2418/1**

**Kodi Postar 1010, Tirana, Albania**

**Tel: +355 4 2254881**

**Mob: 0697889600**

